



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Shkathtësitë dhe kompetencat profesionale, parakushte për vende të reja të punës

(Pasqyrë e punës vjetore nga Agjencia e AAAPARr-s, 2016)



Prishtinë 2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

SHKATHTËSITË DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE, PARAKUSHTE PËR VENDE TË REJA TË PUNËS

(Pasqyrë e punës vjetore nga Agjencia e AAAPARr-s, 2016)

Ai që e do praktikën pa teori është si marinari që hipën në anije pa timon e pa busull dhe kurrë nuk e di se ku mund të shkojë
Leonardo da Vinci



Leximi të bën të plotë, mësimet të bëjnë të gatshëm, të shkruarit të bën të saktë
Frenziz Bekoni

Përgatiti për botim:

Mendohije Krelani

Lektorimi:

Berat Dakaj

Dizajni dhe radhitja kompjuterike:

Gëzim Duzha

Botues:

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr)

Rruga “Agim Ramadani”, kati i tretë

10 000 Prishtinë, Kosovë

<https://aaaparr.rks-gov.net>

Përmbajtja

Hyrje	8
Bashkërisht me partnerët e AAP-s drejt kompetencave profesionale	9
Treguesit e ndryshimeve	10
Zhvillimi i standardeve të profesioneve	10
Zhvillimi i materialeve mësimore	10
Zhvillimi i udhëzuesve	10
Punëtoritë e organizuara dhe të realizuara nga AAAPARr-ja	11
Punëtorja për planin zhvillimor të shkollave	11
Shtohen përgatitjet për fuqizimin e rolit të Agjencisë pas fazës pilote	12
Punëtorja “Menaxhimi efikas i shkollave”	12
ETF ndihmon për hartimin e projektpropozimeve	13
Punëtorja “Rezultatet e AAAPARr-s gjatë fazës pilote 2014-2016”	14
Konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga punëtorja:	15
Punëtori lidhur me Udhëzimin Administrativ të AAAPARr-s	16
Përfaqësuesit e AAAPARr-s, pjesëmarrës në vizita të rëndësishme jashtë vendit	16
Konferenca në Bruksel	16
Rekomandimet e dala nga kjo konferencë ishin:	16
Partneriteti me Shkollën Teknike të Bursës	17
Pjesëmarrje dhe kontribut në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare në Mostar të Bosnjës	18
Vizita studimore në Ankara	18
Qëllimi i punëtorisë:	18
Vizita studimore në Beograd	19
Qëllimi i takimit:	19
Rekomandim	19
Qëllimi i punëtorisë:	20
Rekomandime të përgjithshme:	20
Punëtorja e organizuar në Durrës	20

Qëllimi i punëtorisë:	20
Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme	21
INPO publikoi analizën e hulumtimit për arsimin e mesëm profesional	21
Punëtorja e organizuar nga ETF	23
Pjesëmarrje edhe në këto punëtori:	23
Promovimi i shkollave partnere	24
Panairi Ndërkombëtar “Prishtina 2016”	24
Panairi i 10 Ndërkombëtar i Edukimit	25
Ngritja e kapaciteteve profesionale të AAAPARr-s dhe zhvillimi profesional i mësimeve të mesme	26
Është bërë ngritja e kapaciteteve të stafit të Agjencisë sipas planit vjetor për trajnime nga Instituti për Administratë Publike (IKAP):	26
AAAPARr-ja përfiton projekt nga ETF-ja	27
Bashkëpunimi shkollë/ndërmarrje	28
Disa nga aktivitetet e realizuara nga shkollat	29
ShMLT “11 Marsi” në Prizren	29
Pjesëmarrja në Panairin e Edukimit në Prishtinë	30
ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë	33
Qendra e Kompetencës Malishevë	36
Qendra e Kompetencës Prizren	38
Qendra e Kompetencës Skenderaj	42
Qendra e Kompetencës Ferizaj	45
SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE I FINANCAVE	47
Qeverisja dhe legjislacioni	47
Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore	47
Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Financave	48
Vlerësimi i punës së AAAPARr-s nga shkollat partnere	49
Dreka e fund vitit	51

Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është t'i njoftojmë institucionet përkatëse për të gjitha aktivitetet e realizuara në bazë të planit të Agjencisë së AAPARr-s për punën njëvjeçare. Në këtë periudhë shihet progres në këtë institucion të ri të arsimit të Republikës së Kosovës, sipas strategjive e dispozitave ligjore e nënligjore dhe planit të punës.



Ky raport ka për qëllim:

- Ta pasqyrojë ecurinë e zbatimit të planit njëvjeçar të punës së Agjencisë në mënyrë progresive për vitin përmbyllës të pilotimit sipas kornizës dhe dispozitave ligjore;
- Ta vlerësojë shkallën e arritjes dhe të përmbushjes së obligimeve të parapara në përputhje me objektivat, si dhe prioritetet kryesore të planit operacional të AAPARr-s gjatë kësaj periudhe kohore lidhur me efektin e AAPARr-s për avancimin dhe rritjen e cilësisë së menaxhimit të shkollave, personelit, infrastrukturës dhe financave;
- T'i pasqyrojë në mënyrë sistematike sfidat dhe çështjet problematike që kanë penguar zbatimin e objektivave, duke ua prezantuar këto ministrit dhe MASHT-it, me qëllim të marrjes së masave për zgjidhjen e tyre në periudhën e ardhshme;
- Ta pasqyrojë reflektimin e këtyre aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësim nxënie.



Ragip GJOSHI,
Drejtor i përgjithshëm i AAAPARr-s

Bashkërisht me partnerët e AAP-s drejt kompetencave profesionale

Po e nis këtë fjalë rasti me transformimin e realitetit të arsimit dhe aftësimin profesional, sepse sfida jonë e parë dhe e përbashkët që nga dita kur e nisëm këtë punë ka qenë pikërisht ky.

E kemi nisur ndërtimin e këtij institucioni me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe të donatorëve. Jemi mbështetur edhe nga stafi i këtij institucioni me profesionalizëm, përkushtim dhe aftësi e gatishmëri për t'u përballur me sfida të shumta, shpeshherë edhe të pazakonta.

Në Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur ka ndodhur një menaxhim personeli jashtë çdo parashikimi, një situatë financiare e menaxhuar me nikoqirllëk nga buxheti i pamjaftueshëm, me krijimin e një baze ligjore e cila përbën thelbin e realitetit në të cilin jemi përpjekur t'i përvishemi reformimit të AAP-s dhe sistemit arsimor.

Puna jonë ishte përgjigje për dilemat e zërave të ndryshëm.

Përditë u takova me burra dhe gra të përkushtuara, të cilët vazhdonin të luftonin për dinjitetin e tyre dhe për realizimin e objektivave për ta avancuar nënsistemin e AAP-s. Mes jush, të nderuar miq të AAP-s, gjeta zgjidhjet për përmirësimin e situatës. Puna jonë në thelb është e bazuar në rregull, në traditë dhe trendë globalë bashkëkohorë. Këta elementë, të kombinuar me ruajtjen e vlerave të edukimit dhe të arsimimit, ishin të lidhur gërshetë gjatë punës sonë njëvjeçare. Përsëri e theksoj, zgjidhjet i gjeta në mes të mësimdhënësve dhe menaxherëve të shkollave që menaxhojmë. Gjithmonë gjetëm dritë në fund të tunelit. Drita ishit ju.

Programi i MASHT-it për këtë vit në fushën e AAP-s përmban objektiva të cilat kërkojnë vijimin e reformave dhe transformimin e mëtejshëm të AAP-s, krijimin e kapaciteteve të nevojshme për këtë sektor për përballimin e sfidave.

Në qendër të reformave është krijimi i kompetencës dhe integritetit të profesioneve, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e legjislacionit, kurrikulës, promovimit në karrierë, rritjes së transparencës, llogaridhënies.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur e Kosovës synim kryesor kishte edhe realizimin e objektivit që të funksionojë si truri i gjithë nënsistemit për të gjitha institucionet e arsimit profesional, për monitorimin dhe ndihmesën e hartimit të standardeve të profesionit, të kualifikimeve të profesionit, hartimin e kurrikulave, kurrikulave bërthamë, materialeve mësimore, udhëzuesve, realizimit të trajnimit të mësimdhënësve, të ndërlidhjes me nevojat e tregut të punës, si dhe hartimit dhe fitimit të projekteve ndërkombëtare për një përdorim të efektshëm dhe të shpejtë të të gjitha programeve. I gjithë ky aktivitet shumëpërmasor ishte i orientuar në interes të plotësimit cilësor të misionit përkatës nga çdo strukturë e arsimit profesional.

Treguesit e ndryshimeve

Në këtë fazë në agjendën e ndryshimeve me prioritet ishin:

- Fuqizimi i rolit vendimmarrës të këshillave drejtuese;
- Fillimi i përgatitjes së procedurave për akreditim;
- Analiza dhe hulumtimi i gjendjes së shkollave partnere lidhur me regjistrimin e nxënësve, punësimin, braktisjen dhe orientimin në arsim të lartë;
- Analiza e profileve nëpër shkollat partnere në raport me emërtimet e profesioneve nga lista ekzistuese e klasifikimit të profesioneve, me qëllim të unifikimit me listën e re të klasifikimit të profesioneve;
- Planet zhvillimore të shkollave konform kurrikulës dhe nevojave të tregut të punës;
- Përgatitja e projekt propozimeve nga shkollat.

Zhvillimi i standardeve të profesioneve

Janë zhvilluar standardet e profesioneve në bashkëpunim me bartësit relevantë (shkollat, bizneset) dhe janë përcjell përmes mekanizmave institucionalë (KAAPAR-s dhe AKK-s) si më poshtë:

- Standardi për Transport Rrugor
- Standardi për Trafik Rrugor.

Kurse në proces janë:

- Standardi për drejtues të lëvizjes së trenave
- Standardi për rrobaqepësi
- Standardi për shërbimet e zyrës dhe administratës
- Standardi për murator.

Zhvillimi i materialeve mësimore

- Janë në proces të finalizimit materialet mësimore për:
- Shenjat e trafikut dhe sinjalizimit rrugor
- Siguria në trafikun rrugor I.

Zhvillimi i udhëzuesve

Gjatë këtij viti janë angazhuar ekspertë të fushave përkatëse, të cilët kanë zhvilluar këta udhëzues:

- Udhëzues për mbështetjen e vetëqeverisjes në shkollat e mesme të larta profesionale
- Udhëzues për ndërmarrësi
- Udhëzues për AutoCAD
- Udhëzues për dizajn mode
- Udhëzues për konstruksione të thata
- Udhëzues për analizë të gjendjes aktuale të shkollave profesionale për hartimin e planeve zhvillimore të shkollave
- Udhëzues për metodat e mësimdhënies.



Punëtoritë e organizuara dhe të realizuara nga AAAPARr-ja

Punëtoritë për planin zhvillimor të shkollave

Agjencia e Arsimit dhe Aftësisit Profesional dhe Arsimit për të Rritur më 10 shkurt organizoi punëtorinë për hartimin dhe rishikimin e planeve zhvillimore të shkollave partnere, në të cilën morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, drejtorët, zv/drejtorët, koordinatorët e cilësisë dhe ekipi i angazhuar për PZHS të shkollave partnere të AAAPARr-s. Gjatë kësaj punëtorie, Fikrije Zymberi ka prezantuar një formë të PZHS-s të përgatitur nga zyrtarët e AAAPARr-s, e cila është plotësuar edhe me disa propozime nga të pranishmit, pastaj është bërë një formë unike për gjashtë shkollat partnere të Agjencisë.



Shtohen përgatitjet për fuqizimin e rolit të Agjencisë pas fazës pilote

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) më 10 dhe 11 maj ka organizuar punëtorinë për prezantimin e dokumentacionit të hartuar për rregullativën strategjike dhe të brendshme të këtij institucioni. Në këtë punëtori ishin pjesëmarrës përfaqësues nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, përfaqësues të Këshillit Drejtues të AAAPARr-s, të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, përfaqësues të bizneseve, të shkollave partnere, të Sindikatës së Arsimit etj.

Drejtori i përgjithshëm i AAAPARr-s, Ragip Gjoshi, para të pranishmëve ka prezantuar Draft Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë pas fazës pilote.

Fikrije Zymberi ka prezantuar Udhëzuesin “Mbështetja e vetëqeverisjes në shkollat e mesme të larta profesionale”.

Liridona Shala ka bërë prezantimin e Projekt rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AAAPARr.

Mendohije Krelani dhe Jetmir Berisha kanë bërë prezantimin e hulumtimit për shkollat partnere të AAAPARr-s gjatë fazës pilote. Qëllimi i përpunimit të të dhënave të siguruara me ndihmën e shkollave partnere ishte paraqitja e gjendjes aktuale të shkollave në raport me kualifikimet e mësimdhënësve, numrin e nxënësve për secilin profil mësimor, të arriturat sa i përket regjistrimit dhe, **në fund**, marrjes së informacionit në lidhje me punësimin e nxënësve që e kanë kryer shkollimin e mesëm të lartë.



Punëtorja “Menaxhimi efikas i shkollave”

Është mbajtur punëtorja “Menaxhimi efikas i shkollave” organizuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Qëllimi i punëtorisë ishte prezantimi i të arriturave, problemeve të deritanishme si dhe kërkesat për një menaxhim më efikas të shkollave të AAP-s. Synim vijues ishin efektet e ndryshimeve dhe agjenda e AAP-s në raport me gjendjen fillestare. Në këtë punëtori fillimisht u prezantua, para të pranishmëve nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, Ragip Gjoshi, Udhëzimi Administrativ i cili rregullon qëllimet, objektivat, strukturën dhe funksionet e AAAPARr-s.

Gjoshi ka folur edhe për synimet e këtij institucioni, duke theksuar se arsimi profesional duhet të ketë një adresë, institucion që merret me kurrikula, standarde të profesionit, të materialeve shkollore, hulumtime me kërkesat e tregut të punës. “Për një fazë pesëvjeçare, arsimi profesional është mirë të bëjë përgatitje për decentralizim të plotë. Të trajnohen përfaqësuesit e shkollave për financa në Free Balance, kurse kostoja e financimit të ndryshohet në bazë të kostos së qëndrueshmërisë së profesioneve”, ka thënë Gjoshi.



Kurse Afërdita Jaha nga MASHT-i ka thënë se Agjencia është përkrahur që në fillim të themelimit të saj dhe do të përkrahët edhe më tutje. Kurse Xhelal Susuri, drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale “11 Marsi” në Prizren, ka bërë prezantimin e të arriturave, sfidave (përparësitë dhe mangësitë) në kuadër të AAAPARr-s. Ndërsa rreth procesit të përzgjedhjes së personelit dhe decentralizimit financiar, për një menaxhim më efikas të qendrave të kompetencave, ka folur Armend Bajraktari, drejtor i Qendrës së Kompetencës në Skenderaj. Kurse për partneritetet publiko-privat (PPP), të arriturat, problemet dhe pritjet, ka folur Bashkim Hyseni, drejtor

në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Drejtorët në përgjithësi ishin të kënaqur me të arriturat e deritanishme nën menaxhimin e Agjencisë, duke mos anashkaluar edhe disa probleme sa i përket formulës së financimit. Gjithashtu, kanë kërkuar rishikim të kurrikulave bazë dhe hartim të kurrikulave shkollore sipas specifikave të profesionit, vështirësi në shpenzimin e të hyrave vetjake, të cilat deponohen në llogarinë e thesarit, duke kërkuar që ato mjete të shpenzohen në çdo kohë gjatë vitit financiar pa ndonjë vonesë.

Të pranishëm ishin përfaqësues nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, anëtarë të Këshillit Drejtues të Agjencisë, nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, përfaqësues i Lux/Development, përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës, IPK, si dhe përfaqësues të shkollave partnere të AAAPARr-s.

ETF ndihmon për hartimin e projektpropozimeve

Është mbajtur punëtorja “Projektet demonstruese për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (ZhVP) të mësimdhënësve dhe të trajnerëve të AAP-s në Kosovë”, organizuar nga ETF (European Training Foundation) përmes AAAPARr-s. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte të njoftohen të pranishmit rreth projekteve aktuale demonstruese, si dhe projekteve që mund të mbështeten nga ETF, ku janë informuar me rregullat dhe kriteret se si ata mund t’i propozojnë projektet e tyre, të cilat do të zbatohen në vitin 2017 nëse përzgjidhen.

Drejtori i përgjithshëm i AAAPARr-s, Ragip Gjoshi, ka thënë se çelësi i suksesit është tek mësimdhënësit dhe trajnimet e tij gjatë gjithë jetës. Ndërsa Ryve Prekurogja nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka thënë kjo ministri synon që këtë trajnim ta bëjë në mënyrë të vazhdueshme dhe të gjithë të kenë mundësi të aplikojnë me projekte të ndryshme. Ndërsa sipas Julian Stanley nga ETF, njerëzit duhet të njoftohen se cilat janë praktikatat e mira për trajnimin e mësimdhënësve dhe si të përmirësohen ato ngecje në arsimin profesional që të ketë zhvillim të suksesshëm. Ai ka theksuar se ETF do të jetë këshillues bazuar në praktika të mira.



Punëtorja “Rezultatet e AAAPARr-s gjatë fazës pilote 2014-2016”

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të bëhet prezantimi i rezultateve të arritura të fazës pilote të AAAPARr-s 2014-2016 para përfaqësuesve të institucioneve relevante vendore dhe ndërkombëtare: MASHT-it, MPMS-s, OEK-ut, AKK-s, APFP-s (nga Shqipëria), partnerëve socialë, Lux/Develpoment-it IPK-s etj.

Ragip Gjoshi, drejtor i përgjithshëm i AAAPARr-s, prezantoi të arriturat e Agjencisë gjatë kësaj faze pilotuese. Po ashtu, foli për sfidat, nevojat për ndryshim dhe për planifikimin e Agjencisë në të ardhmen.



Kurse hulumtimin rreth periudhës pilote dyvjeçare 2014-16 të shkollave partnere të AAAPARR-s të realizuar nga Mendohije Krelani dhe Jetmir Berisha, para të pranishmëve e prezantoi Berisha. Nga ky hulumtim është vërejtur rritje e numrit të mësimdhënësve, të nxënësve në krahasim me vitet e kaluara, rënie të braktisjeve së shkollave, si dhe rritje të të punësimit të nxënësve.

Muhamer Ibriqi, zyrtar profesional në AAAPARr, bëri prezantimin e anketës apo hulumtimit, rezultatet e përformancës së AAAPARr-s, që Agjencia ka zhvilluar me shkollat partnere dhe përfitimet e shkollave partnere gjatë kësaj faze pilote për menaxhimin e Agjencisë. Përmes këtij prezantimi kuptuam të arriturat, ndryshimet, përfitimet e shkollave partnere gjatë fazës pilotuese sa janë në menaxhimin e AAAPARr-s. Nga prezantimi i hulumtimit, i cili u pasqyrua edhe me diagrame, u konstatua se gjatë kësaj faze (2014-2016) ka pasur përfitime të matshme të shkollave partnere në menaxhimin e Agjencisë sa iu përket aktiviteteve profesionale (kurrikula, standarde, kualifikime, planprograme, udhëzues, materiale mësimore, etj.), personelit, financave, trajnimeve, infrastrukturës etj.

Fikrije Zymberi, zyrtare në AAAPARr, prezantoi punën dhe kompetencat e KAAPARr-s sipas ligjit dhe arsyeshmërinë e ekzistimit të AAAPARr-s si dhe bashkëpunimin në mes të MASHT-it, AAAPARr-s, AKK-s, IPK-s.

Konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga punëtorja:

1. Bashkëpunim dhe komunikim më i mirë ndërinstitucional për arritjen e progresit për forcimin e AAP-s. Të rishikohen profilet nëpër shkolla dhe të bëhet fuzionimi i planprogrameve në kuadër të profileve të përafërta;
2. Praktika profesionale të realizohet sipas memorandumit të MASHT - OEK dhe institucioneve të tjera relevante;
3. Të punohet më shumë për arritje të autonomisë në shkolla;
4. Në procesin e përzgjedhjes së stafit të mos ketë ndikime politike, por përzgjedhja të bëhet në përputhje të kornizave ligjore;
5. Të punohet më shumë për organizimin e praktikës profesionale në rastin e pagesave të nxënësve, posaçërisht për mbulimin e shpenzimeve të transportit dhe të ushqimit të tyre gjatë kohës së praktikës;
6. Në rast të tepricës teknologjike të punëtorëve në shkolla, të punohet për riorganizimin, përgatitjen apo gjetjen e vendeve të punës për ta;
7. Të bëhet më shumë për shpërndarjen e informatave për të arriturat dhe vizionin për të ardhmen e AAAPARr-s;
8. AAAPARr-ja të vazhdojë të punojë për përgatitjen e shkollave, sidomos të QK-ve për organizimin e mësimin sipas nivelit 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;
9. Pajisjet e QK-ve të shfrytëzohen edhe nga bizneset;
10. Të qartësohet niveli i 4-t pas heqjes së klasës së XIII;
11. Të këtë takime më të shpeshta ndërinstitucionale e të bëhet decentralizimi i plotë i shkollave;
12. Të rishikohen dhe të parashihen profile të reja në bazë të kërkesës së tregut të punës;
13. Të parashihen mekanizma për pagesën e natarëve të KAAPARr-s si institucion i rëndësishëm për promovimin dhe orientimin e politikave të AAP-s;
14. Të bëhet një unifikim dhe riorganizim i AAAPARr-s;
15. Të vazhdohet procesi i hartimit të dokumenteve për vlerësim të brendshëm pas përfundimit të klasës së X, XI, XII;
16. Të shpërndahet raporti dyvjeçar të të gjithë pjesëmarrësit si dhe rekomandimet e dala nga konferenca.



Punëtori lidhur me Udhëzimin Administrativ të AAAPARr-s

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte diskutimi publik për Draft Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe funksionimin e AAAPARr-s pas fazës pilote. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të institucioneve relevante vendore dhe ndërkombëtare: MASHt-i, MPMS-ja, OEK-u, AKK-ja, APFP-ja (nga Shqipëria), partnerët socialë, Lux/Develpoment-i, IPK-ja etj.



Përfaqësuesit e AAAPARr-s, pjesëmarrës në vizita të rëndësishme jashtë vendit

Konferenca në Bruksel

Pas anëtarësimit të AAAPARr-s në EVBB (Asociacionin e Instituteve për Arsim dhe Aftësim Profesional), përfaqësuesit e këtij institucioni, Fikrije Zymberi dhe Liridona Shala, ishin të ftuara në konferencën e organizuar nga EVBB dhe EVTA. Qëllimi i konferencës ishte që të diskutohej për sfidat e reja në AAP, për një përfshirje më të gjerë në Evropë përmes migrimit, bashkëpunimit me qëllim të avancimit të sistemit të AAP-s.



Rekomandimet e dala nga kjo konferencë ishin:

- Mbështetje dhënë AAAPARr-s përmes projektpropozimeve
- Takimi i ardhshëm të mbahet në gjysmën e shkurtit të vitit 2017 në Bruksel
- Të krijohet një platformë elektronike ku të gjitha vendet anëtare të EVBB-s mund të aplikojnë me projekte dhe të kenë mundësi bashkëpunimi.



Partneriteti me Shkollën Teknike të Bursës

Delegacioni nga Kosova, i përbërë nga drejtori i AAAPARr-s, Ragip Gjoshi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren, si dhe drejtorët e katër shkollave (ShMLT “11 Marsi”, ShMP “Ymer Prizreni”, ShFMU “2 Dëshmorët”, ShFMU “Abdyl Frashëri”), janë pritur nga strukturat më të larta arsimore të Prefekturës së Bursës.



Gjatë qëndrimit katërditor janë nënshkruar katër marrëveshje partneriteti me shkollat simotra. Sa i përket ShMLT "11 Marsi", e cila është nën menaxhim të AAAPARr-s, është premtuar ndihmë në makina dhe pajisje, mbështetje për avancimin e kompetencave profesionale të mësimitdhënësve si dhe zhvillim të praktikës profesionale të nxënësve tanë në fabrikat e Bursës.



Pjesëmarrje dhe kontribut në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare në Mostar të Bosnjës

Drejtori i përgjithshëm i AAAPARr-s, Ragip Gjoshi dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme të Kosovës, kanë marrë pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare, e cila është organizuar në Mostar të Bosnjës. Qëllimi i konferencës ishte: ndërtimi i urave në fushën e arsimit të të rriturve.



Vizita studimore në Ankara

Vizita studimore është realizuar nga TAIEX në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Drejtorinë e Sigurisë Sociale të BE-së, Autoritetit të Kualifikimeve Profesionale të Turqisë dhe Fondacionit Evropian për Trajnime (ETF). Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin përfaqësues nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Turqia dhe Republika e Maqedonisë. Kurse nga AAAPAR-ja ishte përfaqësuesja Fikrije Zymberi.

Qëllimi i punëtorisë:

Qëllimi i punëtorisë ishte për të shkëmbyer informacione dhe praktika më të mira për vlerësimin, akreditimin dhe vlefshmërinë e mësimit formal dhe joformal, por dhe të përgatisë rekomandime për vendet se si të vazhdojnë t'i zhvillojnë dhe t'i zbatojnë sistemet kombëtare për vlerësimin e mësimit joformal dhe informal.



Vizita studimore në Beograd

Qëllimi i kësaj vizite të organizuar dhe financuar nga ERISSE, Kulturë Kontakti dhe GIZ-i, ishte të bëhej identifikimi i prioritetëve në fushën e të mësuarit bazuar në punë për një projekt të mundshëm të përbashkët në një të ardhme të afërt. Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin shtetet e vendeve të Evropës Jug-Lindore (EJL). AAAPARr-në në këtë vizitë e ka përfaqësuar Firkije Zymberi.

Qëllimi i takimit:

Për ta përcaktuar temën e interesit të përbashkët për AAP për të gjithë anëtarët e vendeve të EJL-s që janë pjesë e ERISES dhe për t'i përpunuar pjesët kryesore të projektit të ardhshëm në mënyrë që të mund të zhvillohet më tej. Kjo temë u mbështet në punën e mëparshme të rrjetit të vendeve të EJL-s për AAP, mbi konkluzionet e takimeve vjetore dhe punëtorive të mbajtura tashmë, me ç'rast janë identifikuar çështje të ndryshme nga të gjithë pjesëmarrësit.

Rekomandim

Të mësuarit e bazuar në punë është prioritet (e njohur nga EJL, Strategjia, 2020, në kuadër të dimensionit të arsimit dhe kompetencat, si një nga strategjitë kryesore për të siguruar që sistemet më të mira të arsimit dhe trajnimit janë ato që përmbushin nevojat e tregut të punës).



Gjithashtu, më 6 dhe 7 dhjetor është organizuar punëtorja në Beograd lidhur me promovimin e punës bazuar në të mësuar si dhe zhvillimi i standardeve të profesioneve në vendet e EJL-s. Pjesëmarrëse ishin shtetet e vendeve të Evropës Jug-Lindore (EJL) nga Austria, Gjermania, Italia dhe Romania.

Qëllimi i punëtorisë:

Harmonizimi i realizimit të punës bazuar në të mësuarit në sistemin e AAP-s të vendeve pjesëmarrëse, në formën e përbashkët të hartimit të standardeve të profesioneve për të gjitha vendet e ETL-s që janë pjesë e ERISËS dhe për përgatitjen e projekteve për vitin 2017 si mundësi përfitimi nga programi ERASMUS+. Prioritet edhe në këtë punëtori ishte të mësuarit e bazuar në punë (e njohur nga ETL 2020, në kuadër të dimensionit D të arsimit dhe kompetencat, si një nga strategjitë për të siguruar që sistemet e arsimit dhe trajnimit më të mirë t'i përmbushin nevojat e tregut të punës).

Rekomandime të përgjithshme:

- Të formohet grupi rajonal për procesin e zhvillimit të standardeve të profesioneve sipas një forme të përbashkët
- Punëtorja e ardhshme të mbahet në fillim të shkurtit 2017
- Të punohet për projektpropozime për aplikim në programin ERASMUS+.




Punëtorja e organizuar në Durrës

Punëtorja është organizuar nga MASHT-i, Divizioni për AAP, i mbështetur financiarisht nga projekti i Lux-Development. Të pranishëm ishin pjesëmarrësit nga institucionet relevante, si: MASHT-i, MPMS-ja, ME-ja, MPL-ja, AAAPARR-ja, përfaqësues të departamenteve komunale për çështje të financave, drejtorë të shkollave dhe përfaqësues të projektit Lux/Dev.

Qëllimi i punëtorisë:

Rishikimi i rregullores së vitit 2007 lidhur me shfrytëzimin e mjeteve financiare në shkollat profesionale bazuar në sfidat me të cilat ballafaqohen shkollat profesionale dhe harmonizimi i saj me kornizat ligjore të tanishme. Gjatë kësaj punëtorie është finalizuar një draftrregullore për këtë qëllim, e cila pritet të miratohet nga MASH-ti dhe t'u shpërndahet shkollave profesionale.



Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme

Më 19 maj, në kuadër të kampanjës dymujore “EU is About Education and Literacy”, në Qendrën Informative dhe Kulturore të BE-së në Prishtinë u organizua debati nga EU Talks mbi shkollat profesionale në Kosovë. Pjesë e këtij paneli ishte edhe Ragip Gjoshi, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr), Argjentina Grazhdani nga “EYE Project Manager”, Julia Leuther, përfaqësuese e GIZ-it gjerman në Kosovë, Valentina Gara nga Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” i Prishtinës. Gjoshi prezantoi shifra dhe fakte të zhvillimit të arsimit profesional në Kosovë. Ai potencoi rëndësinë e këtij nënsektori për zhvillimin e vendit. Më pastaj, Gjoshi tha se akademizimi i sistemit arsimor duhet t’i lëshojë vend arsimit profesional. Në vazhdim ai foli rreth të arriturave dhe sfidave në arsimin profesional në Kosovë, duke veçuar rëndësinë e rishikimit të kurrikulës, angazhimin e bizneseve për hartimin e standardeve të profesionit dhe rolin e AAAPAR-s për hartimin e materialeve mësimore, hulumtimin e nevojave të tregut të punës dhe ndërlidhjen e institucioneve të AAP-s me bizneset.



INPO publikoi analizën e hulumtimit për arsimin e mesëm profesional

Organizata joqeveritare INPO në një tryezë të thirrur për diskutim për aftësimin e mesëm profesional, ka publikuar analizën e hulumtimit “Përfshirja e të rinjve në zhvillimin e arsimit profesional”. Në hulumtim nxirren në pah paragjykimet për shkollat e mesme profesionale në vendin tonë, (mos)informimi i të rinjve rreth shkollave të mesme profesionale dhe perceptimi i të rinjve rreth cilësisë së procesit mësimor, si dhe faktorët të cilët ndikojnë për përzgjedhjen e drejtimit të arsimit të mesëm të lartë.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin drejtorë të drejtorive komunale të arsimit nga Ferizaj, Prishtina, Mitrovica, Gjilani, drejtorë të shkollave të mesme profesionale, zyrtarë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe vendore, si dhe përfaqësues të nxënësve.

Agim Bytyçi nga MASHT-i, duke vlerësuar hulumtimin e INPO-s, u shpreh se rezultatet dhe të gjeturat e hulumtimit përkojnë me realitetin e gjendjes së arsimit të mesëm profesional dhe sfidat me të cilat përballlet ky sistem arsimor. Sfidë, sipas tij, mbetet hartimi i kurrikulës së arsimit të lartë, proces që e vlerësoi të dështuar deri më tani. Ndërkaq Mendohije Krelani nga AAAPAR-rja vlerësoi se investimi në arsim profesional është investim në ekonomi dhe në të ardhmen e një vendi. Sipas saj, shkollat që ka në përgjegjësi kjo Agjenci kanë arritur të kenë sukses në zhvillimin e procesit mësimor dhe interesimi i nxënësve është i madh, veçanërisht për qendrat e kompetencës.



Krijimi i Këshillave lokale për AAP

AAAPARr në bashkëpunim me projektin USAID -EMPOWER dhe me iniciativën e Sektorit Privat ka themeluar Këshillat Lokale për Arsim dhe Aftësim Profesional (KLAAP) në Prizren dhe Mitrovicë.

Qëllimi i këtyre Këshillave është të orientojë dhe zbatojë politikat e AAP-s lidhur me përmirësimin e punësimit të rinjve në Republikën e Kosovës.

KLAAP udhëhiqen nga sektori privat dhe përfaqësues të këtyre shkollave janë edhe drejtoret e zëvendësdrejtoret e shkollave në Prizren dhe Skenderaj.

Punëtorja e organizuar nga ETF

Qëllimi i punëtorisë ishte harmonizimi i programit mësimor me aftësitë, me fokus të veçantë për matjen e rezultateve të tregut të punës. Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF) ka për qëllim që institucionet (autoritetet) e Kosovës dhe aktorët e tjerë t'i mbështesë dhe t'i këshillojë për ta përmirësuar planifikimin e politikave, zbatimin dhe monitorimin në fushën e zhvillimit të kapitalit njerëzor. Objektivi kryesor i programit të trajnimit ishte ngritja e njohurive teorike dhe praktike mbi metodat për t'i matur rezultatet e punësimit, me fokus në gjurmime dhe hulumtime. Kjo punëtori mundësoi shkëmbimin praktik të informacioneve dhe prezantimeve të rasteve të disa vendeve në këtë lëmë. Pjesëmarrës ishin përfaqësuesit nga: ETF-ja, MASHT-i, MPMS-ja (qendrat e aftësimin profesional), AAAPARR-ja etj.

Pjesëmarrje edhe në këto punëtori:

- Punëtori e organizuar nga MASHT-i për *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë* për vitet 2017-2021, më 3 dhe 4 mars 2016, në "Villa Gërmia" në Prishtinë. Kontributin e vet përfaqësuesit e AAAPARR-s e kanë dhënë në sektorin e arsimit dhe të aftësimin profesional, konkretisht për caktimin e objektivave dhe caqeve të PSAK-ut.
- Punëtori e organizuar nga MASHT-i për *Strategjinë e Arsimit në Kosovë*, konkretisht arsimin për të rritur, më 4 mars 2016 në "Villa Gërmia" në Prishtinë. Është punuar për caktimin e caqeve dhe masave që duhet të përfshihen në PSAK nga arsimit për të rritur.
- Vazhdimi i punëtorisë dyditore për PSAK-un, më 17 dhe 18 mars 2016, në "Villa Gërmia" në Prishtinë. Kanë vazhduar aktivitetet për *përgatitjen e PSAK-ut, përkatësisht në AAP*.
- Punëtorja e organizuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), më 30 dhe 31 maj 2016, në hotel "Emerald" në Prishtinë. Qëllimi i kësaj punëtorie dyditore ishte rishikimi dhe azhurnimi i dokumentit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
- Punëtorja e organizuar nga MASHT-i për *PSAK-un, e mbajtur në hotel "Dukagjini" në Pejë*, më 6 dhe 7 qershor 2016. Plotësimi i dokumentit të sektorit të AAP-s.
- Seminar i organizuar nga AKK-ja për *hartimin e kualifikimeve të AAP-s në hotel "Nartel" në Prishtinë*, më 22 dhe 23 qershor 2016. Përmbajtja ishte: Llojet e kualifikimeve në KKK - dizajne të ndryshme të kualifikimeve. Ndikimi i dizajnit të kualifikimeve formale dhe joformale në AAP. Strukturat e duhura dhe titujt e llojeve të kualifikimeve - kualifikime kombëtare, të kombinuara dhe kualifikime kombëtare profesionale në KKK.
- Punëtorja nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), më 30 qershor dhe 1 korrik 2016, në "Villa Gërmia" në Prishtinë. Qëllimi i punëtorisë: Vazhdimi i punës për rishikimin dhe azhurnimin e dokumentit të KKK-s.
- Punëtorja e organizuar nga AKK-ja më 29 korrik 2016 në "Villa Gërmia" në Prishtinë. Qëllimi i punëtorisë

ka qenë: Vazhdimi i punës së rishikimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

- Punëtorja e organizuar nga AKK-ja më 27 shtator 2016 në hotel “Emerald” në Prishtinë. Qëllimi i punëtorisë ishte: Hartimi dhe rregullat e kombinimit të kualifikimeve në KKK. Ligjëratë nga eksperti ndërkombëtar i kualifikimeve, John Hart.
- Konferencë e organizuar nga MASHT-i, MPMS-ja, MKRS-ja, me temën: Mësimi gjatë gjithë jetës - domosdoshmëri për zhvillim të *përgjithshëm socio-ekonomik*. Mbajtur në hotel “Sirius”, Prishtinë, më 28 shtator 2016.
- Seminar dyditor i organizuar nga AKK-ja për sigurim të cilësisë, mbajtur në hotel “Trofta” në Istog, më 20 dhe 21 tetor 2016. Qëllimi i punëtorisë ka qenë: *Prezantimi* dhe hapat që duhet të merren nga shkollat për raportin e vetëvlerësimit, si dhe përgatitja e projektpropozimeve nga shkollat.
- Konferencë e organizuar nga MASHT-i, me temën: Arsimi për punësim, bashkëpunimi i shkollave profesionale me bizneset, organizuar në hotel “Sirius” më 2 nëntor 2016.
- Konferencë e organizuar nga AKK-ja në hotel “Emerald” më 7 nëntor 2016. Qëllimi i kësaj konference ishte prezantimi i raportit të referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

Promovimi i shkollave partnere

Panairi Ndërkombëtar “Prishtina 2016”

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Isa Mustafa, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Arsim Bajrami, kanë marrë pjesë në hapjen solemne të Panairit Ndërkombëtar “Prishtina 2016”, të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe i mbështetur financiarisht nga Qeveria e Kosovës.



Ky panair ka qenë i hapur nga data 20 deri më 24 prill. Mbi 100 ndërmarrje të ndryshme të Republikës së Kosovës, të rajonit dhe shkolla të mesme të arsimit dhe të aftësisimit profesional, i kanë promovuar produktet dhe pajisjet e tyre si pjesë e aktivitetit dhe punës kreative të nxënësve.



Në mesin e shumë pjesëmarrësve në këtë panair, ishin edhe nxënësit e Qendrës së Kompetencës së Skenderajt dhe të ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” të Prishtinës, të cilët kanë prezantuar disa nga produktet e realizuara nga puna e tyre praktike, në kuadër të zhvillimit të mësimit të nxënësve. Ky panair ishte një mundësi e mirë e promovimit të vlerave dhe mundësive që ofrojnë arsimit dhe aftësimi profesional.

Panairi i 10 Ndërkombëtar i Edukimit

Në panairin dyditor, të mbajtur më 21 dhe 22 prill, nën organizim të Congress and Event Organization (CEO), kanë prezantuar dhe ofertuar programet edukativo- arsimore, si dhe punimet e tyre nxënësit, përkatësisht institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional dhe kolegjet nga trevat e gjithë Republikës së Kosovës dhe të rajonit. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe nxënësit e gjashtë shkollave partnere të AAAPAR-s. Nxënësit e shkollave të ShMLT “11 Marsi” në Prizren, ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, Qendra e Kompetencës në Skenderaj, Qendra e Kompetencës në Malishevë, Qendra e Kompetencës në Ferizaj dhe Qendra e Kompetencës në Prizren kanë prezantuar para vizitorëve të panairit punime të ndryshme të realizuara nga ta. Pjesëmarrja në këtë ngjarje të shkollave të AAAPAR-s është përkrahur nga Lux-Development.



Ky panair është vizituar edhe nga ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Arsim Bajrami, i cili është shprehur se “ky panair është një mundësi e mirë që të promovohen mundësitë që ka sfera e edukimit, sidomos e arsimit profesional, në mënyrë që vizitorët t’i shohin shkathtësitë dhe inovacionin e nxënësve tanë”.

Pjesëmarrjen e gjashtë shkollave partnere të AAAPARr-s në këtë ngjarje e ka vlerësuar lart edhe drejtori i përgjithshëm i këtij institucioni, Ragip Gjoshi, duke theksuar se AAP furnizon tregun me të gjithë profesionistët e mesëm, që janë motori i çdo ekonomie sa iu përket burimeve njerëzore.

Edhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, vizitoi shkollat partnere të AAAPARr-s dhe i vlerësoi shumë prezantimet nga ana e nxënësve. Madje Ahmeti në stendën e nxënësve të Qendrës së Kompetencës së Ferizaj, e cila është e profileve të shëndetësisë, u ndal ta masë shtypjen e gjakut.



Për dy ditë radhazi ky panair është vizituar nga përfaqësues të DKA-ve, përfaqësues të shkollave të ndryshme të Kosovës, së bashku me nxënës dhe qytetarë të shumtë. Në fund të panairit, shkollat janë pajisur me nga një certifikatë për pjesëmarrje të suksesshme në Panairin e Edukimit.


Ngritja e kapaciteteve profesionale të AAAPAR-s dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Është bërë ngritja e kapaciteteve të stafit të Agjencisë sipas planit vjetor për trajnime nga Instituti për Administratë Publike (IKAP):

- Komunikim me publikun
- Menaxhim të dokumenteve arkivore
- Lidership dhe menaxhim
- Përafrim të legjislacionit me BE-në
- Trajnim për SIMBNj (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore)
- Trajnim të tre përfaqësuesve të AAAPAR-s për “Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve”, organizuar nga IKAP.

Po gjatë këtij viti janë realizuar trajnime pedagogjike-didaktike dhe didaktike/profesionale që kanë ndikuar në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve të katër qendrave të kompetencës dhe të dy shkollave profesionale partnere të AAAPAR-s. Këto trajnime kanë ndikuar që ata të kenë shkathtësi pedagogjike dhe të gëzojnë përkrahje për zhvillimin e aftësive dhe karrierës së tyre. Përveç këtyre trajnimeve, në përputhje të udhëzuesve të përgatitur janë realizuar:

Trajnim për AutoCAD, të cilin e kanë vijuar 20 mësimitdhënës;



Trajnim për dizajn mode, të cilin e kanë vijuar 10 mësimdhënës.



Në bashkëpunim me DVV International janë certifikuar 34 mësimdhënës në katër modulet e para nga programi “Curriculum GlobALE” për trajner në arsimin e të rriturve.



AAAPARr-ja përfiton projekt nga ETF-ja

AAAPARr në bashkëpunim me Institutin ITED është përfituese e grantit nga ETF-ja për trajnimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve (CPD) me projektin “Trajnimi i mësimdhënësve në AutoCAD 2D”, ku përfitues do të jenë 17 mësimdhënës.



Bashkëpunimi shkollë/ndërmarrje

Gjatë kësaj periudhe është rritur bashkëpunimi me komunitetin e biznesit krahasuar me vitin e kaluar dhe janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani si më poshtë:

ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë ka arritur 87 marrëveshje. Krahasuar me tërë vitin e kaluar shkollor, ka pasur 30 marrëveshje;

ShMLT “11 Marsi” në Prizren ka arritur 51 marrëveshje. Krahasuar me vitin e kaluar shkollor, 30 marrëveshje;

QK në Skenderaj ka arritur 25 marrëveshje, ndërsa për tërë vitin e kaluar shkollor ka pasur 30 marrëveshje;

QK në Ferizaj ka arritur 28 marrëveshje, ndërsa për tërë vitin e kaluar shkollor ka pasur 50 marrëveshje;

QK në Malishevë ka arritur 63 marrëveshje, ndërsa për tërë vitin e kaluar shkollor ka pasur 56 marrëveshje;

QK në Prizren ka arritur 15 marrëveshje, ndërsa për tërë vitin e kaluar shkollor ka pasur 10 marrëveshje.

Disa nga aktivitetet e realizuara nga shkollat

ShMLT “11 Marsi” në Prizren

Partneriteti me KFOR-in gjerman

Në kuadër të partneritetit reciprok, kontingjenti gjerman i KFOR-it më 14 janar 2016 shkollës i dhuroi 30 kompjuterë.



Dita e Shkollës

Dita e Shkollës organizohet çdo vit për nder të Betejës së Jeshkovës. Më 11 mars 1999 mbi 3 000 pjesëtarë të forcave armike serbe, të mbështetura me arsenal të paparë të makinerisë ushtarake, sulmojnë pozicionet e 30 pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Brigadës 125 të ZOP në fshatin Jeshkovë të Vrrinit. Në mesin e 22 dëshmorëve të rënë në këtë betejë, shumica e tyre kanë qenë ish-nxënës të shkollës sonë. Sikurse në vitet e tjera, edhe në këtë vit, për nder të Ditës së Shkollës, në Pallatin e Kulturës në Prizren është organizuar një program kulturor-artistik nga nxënësit e kësaj shkolle dhe nga nxënësit e ShMM “Lorenc Antoni”, kurse gjatë javës së parë të marsit janë organizuar gara në futboll të vogël. Në të njëjtën ditë në Varrezat e Dëshmorëve në Landovicë janë vendosur kurora me lule.



Më 11 mars 2016: Kurora me lule për dëshmorët e kombit.



Më 11 mars 2016: grupi artistik i nxënësve të shkollës sonë.

Dita e Dyerve të Hapura

Dita e Dyerve të Hapura organizohet çdo vit më 11 mars. Në këtë ditë shkolla ka hapur dyert për nxënësit e klasave të nënta, për bizneset dhe prindërit. Vizitorët janë njoftuar me kushtet dhe mundësitë që ofron shkolla si vatër e AAP-s për ardhmërinë e të rinjve tanë. Nxënësit tanë në kabinetet e shkollës, në prani të vizitorëve, kanë demonstruar shkathtësitë e tyre praktike, kurse në hollin e madh të shkollës është hapur një ekspozitë madhështore me punimet e nxënësve të profileve që u përkasin arteve aplikative dhe arkitekturës.

Më 11 mars 2016 shkolla jonë ka kremtuar 55-vjetorin e themelimit.





Pjesëmarrja në Panairin e Edukimit në Prishtinë

Nxënësit e shkollës sonë nga profilet e dizajnit të modës, dizajnit grafik dhe arkitekturës më 22 prill 2016 kanë marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Edukimit në Prishtinë.



Gjatë javës së parë të muajit maj mësimdhënësit tanë para nxënësve të klasave të nënta të shkollave të mesme të ulëta të Prizrenit dhe të rrethinës, shpалosen mundësitë që ofron shkolla jonë për të ardhmen e tyre.



Trajnimi i mësimdhënësve të profilit Dizajn metalesh

Gjatë këtij viti shkollor është mbajtur trajnimi nga profili Dizajn metalesh për herë të dytë nga eksperti i GIZ-it, Stefan Jungblut. Trajnimi ka filluar më 2 maj 2016 dhe ka zgjatur pesë ditë.



Organizimi i ekskursionit për maturantë

Në këtë vit ekskursioni për maturantë është organizuar nga data 13 maj deri më 18 maj 2016, kurse mbrëmja e maturës është mbajtur më 21 maj 2016.



Kompletimi i dy kabineteve të dizajnit të modës

Pas disa takimeve, OQ TIK-a nga Republika e Turqisë na mundësoi kompletimin e dy kabineteve për nxënësit e profilit të dizajnit të modës, një në paralelen e ndarë në Reqan dhe një në qendër tjetër. Në këtë vit shkollor për herë të parë nxënësit i kanë qepur vetë uniformat për nxënësit e klasave të dhjeta.



Garat komunale në basketboll

Gjatë muajit tetor nxënësit e ShMLT “11 Marsi” në Prizren morën pjesë në garat komunale në sportin e basketbollit, në të cilat ShMLT “11 Marsi” arriti ta fitojë vendin e dytë në konkurrencën e meshkujve dhe në atë të femrave.



Korrupsioni dhe transparenca në shkolla

Më 9 dhjetor 2016 Këndi Amerikan, i cili vepron në kuadër të Bibliotekës Komunale në Prizren, me financim dhe mbështetje nga Ambasada Amerikane, ndau çmime për nxënësit e shkollave të mesme, me ç’ rast nxënësi Sadri Maloku nga ShMLT “11 Marsi” në Prizren zuri vendin e parë në pikturë, me temën “Korrupsioni dhe transparenca në shkolla”.



Trajnimi i mësimeve me temën “Aplikimi i TIK-ut në arsim”

Në kuadër të projektit të BE-së për “Aplikimin e TIK-ut në arsim”, më 10.12.2016 janë trajnuar 19 mësime të shkollës sonë. Para katër vjetëve Zyra e BE-së në kuadër të MASH-it e ka kompletuar me 10 kompjuterë dhe katër lloj laptopë kabinetin e “Të mësuarit nga largësia”.



ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë

Më 17-30.01.2016 qëndrimi i Bernd Techau në shkollë dhe trajnimi i pesë mësimeve të kësaj shkolle dhe të dy mësimeve të shkollës “11 Marsi” nga Prizreni për aftësim shtesë në automekanikë;

Më 11.01.2016 takim në shkollë me Fikrije Zymberin dhe stafin e AAAPAR-s. Qëllimi i takimit ishte plani zhvillimor i shkollës, të dhënat për stafin 2014/15 dhe trajnimet e mësimeve;

Më 14.01.2016 takim i AAAP-s dhe ARR-s me këtë rend dite: Planin zhvillimor i shkollës 2015\16, plani i KESH-it, hartimi i projekteve ndërkombëtare dhe identifikimi i nevojave të shkollës.



Në po të njëjtën ditë për vizitë ishte edhe Eda Cauli nga Tirana, drejtoreshë e “Integral Britanika”, për mundësinë e nxënësve për të studiuar në botën e jashtme. Informimi për takimin që do të mbahet në hotel “Sirius” Prishtinë dhe pjesëmarrja e një grupi të caktuar të nxënësve të shkollës;

Më 18.01.2016 takimi me Bernd Techaun lidhur me temën “Trajnimi i menaxhmentit”;

Më 20.01.2016 shërbimi sprovës në Ministrinë e Drejtësisë;



Më 21.01.2016 organizimi i takimit punues në RIINVEST në bashkëpunim me OEK-un dhe Lux-Dev lidhur me bashkëpunimin e shkollës me biznese dhe punësimi i të rinjve;

Më 22.01.2016 takimi me Bernd Techaun me Mithat Bylykbashin dhe përfaqësues të tjerë të shkollës lidhur me kontrollimin e mësimdhënësve dhe vëzhgimin e procesit mësimor dhe financat e shkollës;



Më 26.01.2016 takimi me drejtorin e shkollës “Arsimi i Shqipërisë”, me temën “Riciklimi i trajnimeve të nxënësve nga mosha 15-25 vjeç për tre muaj”;

Më 28.01.2016 trajnimi i menaxhmentit me Bernd Techaun për financat etj;

Më 10.02.2016 në hotel “AFA”, punëtorja e AAAPARr-s lidhur me PZhSh-në;

Më 15.02.2016 mbledhja e dytë e Këshillit Drejtues të shkollës për temat: Suksesi, zbatimi i vendimit, salla, ndërrimi i rregullores për të hyrat vetjake dhe të ndryshme;



Më 18.02.2016 takim me Hamit Beqirin, drejtor i Shkollës “Arkitekt Sunani” në Mitrovicë;

Më 19.02.2016 takimi me përfaqësuesit e Transfuzionit të Gjakut për caktimin e datës për dhurim të gjakut;

Më 23.01.2016 vizitë e zyrtarëve të DKA-s së Prishtinës, me qëllim të shkëmbimit të informatave;

Më 24.02.2016 takim me përfaqësuesit e Shërbimit të Sprovës në kuadër të Ministrisë së

Drejtësisë, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me shkollën për punësimin e të dënuarve me kusht në kohë të caktuar dhe takimi më 29.02.2016 dhe 01.03.2016.



Më 29.02.2016 takimi në zyrat e AAAPARr-s;

Më 03.03.2016 takim me përfaqësuesit e HELVETCA, Stefan Butscher, Roe Hakemolder, Ajeta Lleshi dhe Majlinda Bajraktari;

Më 08-09.03.2016 SMIA, futja e shënimeve për shkollën;

Më 14.03.2016 Instituti Pedagogjik i Kosovës diskuton për arsim dhe aftësim në arsim dhe formim;

18.03.2016 TRIOTEC, bisedë për mundësinë e vendosjes së kamerave dhe rrjetit të internetit në shkollë;

22.03.2016 takim me ekspertin Bernd Techaun, Mithatin Bylykbashi, Blerim Gërvalla dhe Ymridin Tërshnjaku lidhur me kontrollin, paraplanifikimin, planifikimin dhe zbatimin;

Më 23.03.2016 takimi me përfaqësuesit e AAAPARr-së, lidhur me akreditimin e shkollës për profile në formë të veçantë;

Po të njëjtën ditë RTV bën një reportazh për shkollën me moderatorin Hekuran Krasniqin;

Më 24.03.2016 kontrollimi i ditarëve dhe evidentimi i njësisë mësimore;



Më 25.03.2016 është punuar rreth Planit Zhvillimor të shkollës dhe është formuar grupi punues;

Më 29.03.2016 AGS, F. Kosovë, kërkesë për punësimin e katër nxënësve të automekanikes;

Më 31.03.2016 takimi në mes të Bernd Techaun dhe menaxhmentit të shkollës;

25.04.2016 vizita e Parlamentarëve të Republikës së Nordrhein - Westfalen, presidentit dhe 20 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Safet Gërxhaliu nga OEK-u dhe shkolla;



Më 27.04.2016 shërbimi sprovës për punësimin e një punëtori për kohë të caktuar;
 Më 03.05.2016 takim me ekspertin Bernd Techaun dhe marrja e ftesave nga shtypshkronja “Blendi” për ditën e shkollës ;
 Më 05.05.2016 “Dita e Dyerve të Hapura”, parapërgatitja për aktivitete;
 Më 06.05.2016 mbledhja e Këshillit të Arsimitarëve për përgatitjen “Dita e Dyerve të Hapura”;
 Më 11.05.2016 “Dita e Dyerve të Hapura”.

Qendra e Kompetencës Malishevë

Regjistrimi i nxënësve në klasën e X për vitin shkollor 2016/2017 sipas konkursit të shpallur më 14.06.2016
 Më datën e cekur më lart e kemi hapur konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasën e X për vitin shkollor 2016/2017,
 i cili ka qenë i hapur deri më datë 17.06.2016, sepse më datë 16.06.2016 e kemi shënuar Ditën e Çlirimit të Malishevës.



Përmbledhje e disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë vitit shkollor 2016/2017

Më 29.04.2016 kemi marrë pjesë në Panairin e Firmave Ushtrimore, në të cilin nxënësit tanë kanë pasur mundësinë në mënyrë praktike t'i demonstrojnë njohuritë e tyre të fituara në shkollë. Mund të themi se nxënësit tanë na kanë përfaqësuar mjaft mirë në këtë panair.



Më datë 06.05.2016 e kemi organizuar Panairin “Ditët e Dyerve të Hapura”. Në këtë panair secili nga gjashtë profilet e shkollës sonë kanë prezantuar punën e tyre me nga një kënd të veçantë në hapësirat e shkollës ku mësimdhënësit, bashkë me nxënësit, kanë bërë

prezantimin e profileve para mysafirëve të shumtë që kishim. Ishte një mundësi shumë e mirë edhe për nxënësit të cilët ishin në prag të përfundimit të klasës së IX-të të njoftoheshin për së afërmi me mundësitë që i ofron shkolla jonë. Në këtë panair kishim një numër të konsiderueshëm të vizitorëve të cilët u ndanë të kënaqur me organizimin dhe mbarëvajtjen e panairit. Në fund të këtij panairi kemi organizuar edhe një koktej në restorantin e shkollës, në tavolinat e të cilit nxënësit tanë kishin shtruar ushqime tradicionale.



Më datë 14.05.2016 kemi organizuar Mbrëmjen e Maturës me maturanët e shkollës sonë në një restorant në Malishevë. Ishte një organizim mjaft i mirë dhe nxënësit u ndanë të kënaqur. Përzgjedhja e operatorit për realizimin e Mbrëmjes së Maturës është bërë me tender publik. Kanë aplikuar disa operatorë dhe nxënësit, sipas bindjes së tyre, e kanë përzgjedhur operatorin për të cilin kanë menduar se i plotëson kushtet. Pra, i tërë ky proces ka qenë tejet transparent. Operatori i përzgjedhur ka ofruar kushte të mira, por edhe çmimi për nxënës ka qenë i arsyeshëm.

Shënimi i ditës së shkollës më datë 02.12.2016

Më datë 02.12.2016 e shënuam Ditën e Shkollës me disa aktivitete dhe një program të pasuar, të organizuar nga nxënësit e shkollës.



Qendra e Kompetencës Prizren

Gjatë këtij viti janë realizuar një sërë aktivitete:

Në muajin janar:

- Takime në Prishtinë me AAAPARr, LuxDev dhe të tjerë;
- Mentorimi në orë mësimore;
- Trajnim, mentorim, vlerësim, Lux-Dev;
- Përgatitja e materialeve mësimore për vitin 2016-2017 shkollor;
- Takim me përfaqësuesit e aktiveve profesionale;
- Përgatitja e planit të promovimit të Qendrës së Kompetencës, i përfshirë RINVESTI;
- Praktika profesionale e nxënësve në biznese.



Në muajin shkurt:

- Kontakti me biznese për bashkëpunim;
- Takimet në Prishtinë me drejtorin e AAAPARr-s, Ragip Gjoshi, me udhëheqës të LuxDev dhe të tjerë;
- Plotësimi i formularëve për numrin e nxënësve të regjistruar në QK Prizren;
- Pjesëmarrja në punëtorinë e AAAPARr-s: “Hartimi i planit zhvillimor të shkollës, forma unike” ;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e KLAAP – USAID;
- Përgatitja e materialeve mësimore;
- Trajnimi monitorim, evaluim;
- Takim me Këshillin e Shkollës;
- Takim me përfaqësuesit e aktiveve profesionale;
- Praktika profesionale e nxënësve në biznese.



Në muajin mars:

- Organizimi i praktikës profesionale;
- Pjesëmarrja në kuisin e diturisë e nxënësve të QK-s;
- Takim për festën e mësuesit;
- Kontakti me biznese për bashkëpunim;
- Takimet në Prishtinë me AAAPARr-në, LuxDev-in dhe të tjerë;
- Takim me AKK;
- Përgatitja e materialeve mësimore;
- Trajnimi, ngritja e kapaciteteve profesionale financuar nga Lux-Dev;
- Takim me përfaqësuesit e aktiveve profesionale;
- Praktika profesionale e nxënësve në biznese.



Në muajin prill:

- Takime në QK me donatorin Lux-Dev;
- Trajnimi, monitorimi dhe vetëvlerësimi AKK;
- Pjesëmarrje me nxënës dhe profesorë në Panairin e Edukimit në Prishtinë;
- Takim me përfaqësuesit e aktiveve profesionale;
- Promovimi i QK në shkolla të mesme të ulëta në Prizren dhe region.

Në muajin maj:

- Takime në QK me përfaqësuesit e ETF program;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e AAAPARr në Pejë;
- Organizimi i Ditëve të Dyerve të Hapura;
- Takime në QK me donatorin Lux-Dev;
- Mentorim në procesin mësimor, faza e dytë;
- Draft raporti i planit biznesor;
- Java promovionale e QK-s me mësimdhënës në shkollat fillore në Prizren dhe rrethinë;



- Pjesëmarrje në punëtorinë e AKK-s;
- Promovimi i QK-s me biçikleta nga nxënësit tanë;
- Praktika profesionale e nxënësve në biznese.

Në muajin qershor:

- Përgatitja e materialeve mësimore;
- Shëtitje njëditore me nxënës të shkollës në Shqipëri;
- Takim me këshillin e shkollës;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e Lux-Dev;
- Plotësimi i pyetësorëve të QK-s nga AAAPARr-ja;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e AAAPARr-s ;
- Hapja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në QK;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e AAAPARr-s;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e AKK-s.

Në muajin korrik:

- Trajnim, mentorim, vlerësim nga Lux-Dev;
- Përgatitja për ndarjen e normave;
- Përgatitja për hapjen e konkursit për vitin e ri akademik 2016/17;
- Pjesëmarrës në takim me biznese. I pranishëm, ministri Enver Hoxha;
- Takim për procesin e pranim-dorëzimit të objektit të QK Prizren;
- Pranimi i aplikacioneve për punë.



Në muajin gusht:

- Takime në Prishtinë me drejtues të AAAPARr-s, të LuxDev-it dhe të tjerë;
- Dhënia e kabinave me qira “univers training”;
- Intervistimi i kandidatëve për punësim;
- Rishikimi i planit zhvillimor dhe vjetor të punës;
- Hapja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në QK;
- Rifformatim i planit të biznesit;
- Takime në QK me donatorin Lux-Dev.

Në muajin shtator:

- Ceremonia e hapjes së vitit të ri shkollor në orën 10.30;
- Të njihemi me rregulloren e shkollës;
- Takime në Qendrën e Kompetencës me donatorin Lux-Dev dhe përfaqësuesit e PEARSON-it;
- Bartja e uniformave brenda objektit të Qendrës së Kompetencës;
- Takim me përfaqësuesit e aktiveve profesionale;
- Takim me këshillin e shkollës;
- Takimet në Prishtinë me drejtues të AAAPARr-s, të LuxDev-it dhe të tjerë;
- Praktika profesionale e nxënësve në biznese;
- Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit të Qendrës së Kompetencës Prizren.

Në muajin tetor:

- Zgjedhja e bordit të shkollës;
- Mentorimi në orët mësimore;
- Identifikimi i orëve të praktikës profesionale brenda dhe jashtë ndërtesës;
- Takimet në Prishtinë me drejtues të AAAPARr-s, të LuxDev-it dhe të tjerë;
- Vizitë Muzeut Mobil të Kosovës në Qendrën e Kompetencës;
- Trajnim nga PEARSON për profesorë dhe staf;
- Dhënia e kabineteve me qira;
- Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit të Qendrës së Kompetencës në Prizren;
- Mentorim në orën mësimore.

Në muajin nëntor:

- Përgatitja e panairit për Qendrën e Kompetencës, ndarja e detyrave për nxënësit;
- Takim me Institutin Pedagogjik të Kosovës;
- Mentorim i mësimdhënësve;
- Organizim i praktikës profesionale;
- Takimet në Qendrën e Kompetencës me drejtues të AAAPARr-s, të LuxDev-it dhe të tjerë;
- Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit të Qendrës së Kompetencës në Prizren;
- Dhënia me qira e amfiteatrit;
- Dorëzimi i raportit të vetëvlerësimit në AKK.

Në muajin dhjetor:

Qendra e Kompetencës Skenderaj

Këtë raport pune për Shkollën e Mesme Profesionale Qendra e Kompetencës në Skenderaj për periudhën kohore 01.01.2016 deri më 13.12.2016, për aktivitetet që kanë ndodhur në këtë qendër, po e paraqesim në vijim:

- Procesi mësimor;
- Praktika në ndërmarrje;
- Mjetet financiare të përdorura deri në këtë periudhë (buxheti i shkollës);
- Mjetet e fituara nga donacionet;
- Stafi mësimor;
- Trajnimet.

Procesi mësimor për këtë vit shkollor vazhdoi sipas planifikimit. Fillimisht u hartua plani zhvillimor i shkollës për vitin 2016/2019 me rishikime kohë pas kohe, u hartua një plan i thjeshtë, me objektiva të cilat dalin nga kërkesat dhe nevojat që ka shkolla.



Plani vjetor i punës së drejtorit u prezantua para Këshillit të Shkollës për një debat konstruktiv në lidhje me zhvillimet dhe objektivat e parapara në planin zhvillimor. Edhe stafi mësimor ka arritur në një nivel më të avancuar për hartimin e planeve të punës për lëndë të caktuara, sidomos për realizimin e praktikës profesionale. Kjo është bërë e mundur falë trajnimeve dhe organizimit të brendshëm që janë bërë për këto vite të punës. Megjithatë, ka vend për përmirësim, sidomos për zbatim të trajnimeve dhe metodave më të avancuara të kohës për sukses dhe ngritje të cilësisë.



Furnizimi i shkollës me materiale, vegla, pajisje dhe elemente përcjellëse për realizimin e procesit të mirëfilltë dhe të suksesshëm nuk kanë munguar dhe se me mundësi financiare që kemi pasur, furnizimi është i mirë. Ky ndoshta është viti më i suksesshëm me furnizime, sidomos për realizimin e praktikës profesionale në shkollë në të gjitha profilet. Janë mbajtur takime të rregullta në nivel të shkollës. Puna ekipore e stafit mësimor dhe atij udhëheqës janë objektivat e shkollës për një sukses në ngritje. Është e rëndësishme të ceket se këtë vit kemi ngritje në regjistrimin e nxënësve në klasën e X. Në krahasim me vitin e kaluar, sivjet ngritja është 30 %. Në vijim, nëpërmjet disa fotografive, po i paraqesim aktivitetet gjatë këtij viti shkollor:



Vizita e ambasadorit norvegjez së bashku me gratë deputete të Kuvendit të Kosovës



Klasat e XII-ta të shkollës këtë vit, sikurse edhe në vitet e tjera, realizojnë punën praktike nëpër kompani, me një përqindje të mirë krahasuar me gjendjen ekonomike dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë aktivitet. Realizimi i punës praktike këtë vit është rreth 62.23 %. Kjo përqindje synohet të ngritët, mirëpo ka faktorë të cilët duhet të rregullohen me qëllim që të kemi një pjesëmarrje më të madhe të nxënësve në kompani siç janë: sigurimi shëndetësor, transportimi i nxënësve, ushqimi e elemente të tjera.

Buxheti i shkollës këtë vit ishte i mirë në përgjithësi, duke i mbuluar nevojat e shkollës. Por, probleme mbeten investimet kapitale. Edhe pse shkolla është e re, ka probleme teknike që kërkojnë investime në mirëmbajtje, sidomos në mbulesën prej kulmi, dyshemeja prej epoksidi, tarraca ka nevojë për izolim, sistemi i ngrohjes etj.



Donacione këtë vit nuk kemi pasur, edhe pse kemi bërë kërkesë në disa institucione për projekte të ndryshme.

Stafi mësimor këtë vit nuk ka ndryshime nga viti i kaluar. Këtë vit kemi pranuar një mësimdhënës të ndërtimitarisë me konkurs të rregullt. Staf mësimor të rregullt janë gjithsej 30 mësimdhënës.

Këtë vit disa nga mësimdhënësit kanë ndjekur trajnime të organizuara nga AAAPARR-ja, si: trajnime për mësim për të rritur, trajnime për programin e Auto Cad-it, për dizajn të tekstilit dhe të veshjeve. Tash pritet të fillojnë trajnimet për metodikë dhe didaktikë profesionale.

Qendra e Kompetencës Ferizaj

Qendra e Kompetencës në Ferizaj ka realizuar në tërësi obligimet dhe detyrat e parapara me planin vjetor të punës dhe obligimet në përputhje të përshkrimit të detyrave të punës.

Vlen të theksohet se është bërë vlerësimi i brendshëm i maturantëve.



Është mbajtur Testi Kombëtar i Maturës. Prej 186 maturantëve pjesëmarrës, 179 e kanë kaluar në raundin e parë, ndërsa gjashtë të tjerë në raundin e dytë (vetëm një nxënës ka dështuar në të dy afatet). Po ashtu, është bërë regjistrimi i nxënësve, ku në afatin e qershorit janë regjistruar 144 nxënës në gjashtë profile shëndetësore. Janë realizuar edhe aktivitete jashtëshkollore, si: mbrëmja e maturës, ekskursioni, vizitat dhe që të gjitha kanë kaluar bazë të planifikimit, duke i plotësuar objektivat e parapara. Në aspektin administrativ/financiar është bërë plotësimi i vendeve të punës sipas konkursit të afatit të gushtit.



Është shpenzuar buxheti sipas kategorive të parapara dhe me kohë. Këtë vit ka filluar trajnimi me Organizatën PEARSON, e sponsorizuar nga Lux-Development, për profilin Farmaci, i cili është në proces e sipër si dhe janë zhvilluar një varg aktivitete të përbashkëta me donatorin nga Luksemburgu.

SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE I FINANCAVE

Qeverisja dhe legjislacioni

Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore

Me rastin e bartjes së kompetencave edhe për menaxhimin e financave dhe personelit për gjashtë shkollat partnere të AAAPARr-s, para këtij sektori dolën një varg sfidash. Kështu, gjatë vitit 2015/2016 janë bërë hapa progresivë për të vendosur një shërbim sa më cilësor në këtë rrafsh. Të gjitha veprimet tona të ndërmarra kanë shkuar në orientim të rritjes së autonomisë së shkollave, duke e aftësuar menaxhmentin e shkollave për përzgjedhjen e personelit të mësimdhënësve dhe atë administrativ në përputhje me kornizat ligjore. Ndërsa gjatë këtij viti, në tremujorin e parë, në fokus ka qenë përgatitja për vitin shkollor 2016/2017, duke bërë planifikimet për regjistrimin e nxënësve, sipas kërkesës dhe njoftimeve që ka bërë MASHt-i, përgatitjet për shpalljen e konkurseve për rekrutimin e personelit mësimdhënës në ato shkolla ku ka pasur nevojë. Gjithashtu, kanë vazhduar të bëhen organizime të aktiviteteve shkollore të cilat janë realizuar sipas planit të punës. Aktivitetet e realizuara në këtë fazë kanë qenë: ekskursioni për maurantët, mbrëmjet e maturës, procesi i mbylljes së vitit shkollor, përgatitja e konkurseve për regjistrim të nxënësve për vitin shkollor 2016/2017 si dhe aktivitete të tjera. Ndërsa gjashtëmujori i dytë i vitit për ne ka qenë i orientuar në pajisjen me kontrata, harmonizimi i tyre me aktet ligjore, ndryshimet në listën e pagave, përgatitja e planit të personelit për 2017-n sipas udhëzimeve të MAP-it, që këtë vit ka qenë risi për shkollat, përgatitja e stafit për vlerësimin vjetor - caktimi i objektivave dhe obligimet që kemi në baza mujore. Më poshtë janë disa prej aktiviteteve që janë realizuar gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2016.

- Rifreskimi dhe plotësimi i ndryshimeve të dosjeve të personelit të AAAPARr-s dhe shkollave partnere sipas legjislacionit në fuqi;
- Është finalizuar Udhëzimi Administrativ mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) në mbështetje të legjislacionit aktual;
- Në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të MASHt-it dhe sipas udhëzimeve të Ministrisë së Administratës Publike është finalizuar Rregullorja e Brendshme për Sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur;
- Në bashkëpunim me Divizionin e Burimeve Njerëzore të MASHt-it është hartuar plani i personelit, struktura organizative, përshkrimi i vendeve të punës; janë harmonizuar aktet e emërimit sipas katalogut të vendeve të punës për stafin e Agjencisë, bazuar në kërkesat e Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave;

- Është trajnuar dhe vazhdon të trajnohet stafi i Agjencisë për vendosjen e të dhënave në Sistemin Informativ të Burimeve Njerëzore (SMBNj);
- Krijimi i dosjeve dhe lidhja e kontratave me bashkëpunëtorët e jashtëm të AAAPARr-s lidhur me aktivitetet e institucionit sipas njoftimeve të publikuara në uebfaqe të AAAPARr-s;
- Me kërkesë të shkollave janë proceduar dhe janë finalizuar hapja e gjashtë (6) uebfaqeve zyrtare, të cilat janë të lidhura me uebfaqen e Agjencisë me përmbajtje të unifikuar;
- Është themeluar komisioni për bashkëpunim me bizneset dhe për përkujdesjen e sigurimit shëndetësor të nxënësve gjatë praktikës profesionale në sektorin privat dhe atë publik të shkollave partnere të Agjencisë;
- Me kërkesë të shkollave është bërë publikimi për hapjen e ftesës për ofertë për realizimin e ekskursioneve për maturantët e shkollave partnere të Agjencisë (vlen të ceket se për zhvillimin e këtyre procedurave nuk kemi pasur asnjë ankesë);
- Me kërkesë të menaxhmentit të shkollave janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen ndryshimet sipas nevojave të personelit mësimdhënës dhe administrativ lidhur me ndryshimet mujore;
- Shpallja e konkurseve për angazhimin e trajnerëve dhe ekspertëve për trajnimin e mësimdhënësve të shkollave profesionale partnere të AAAPARr-s sipas planit vjetor të punës. Trajnimi i **mësimdhënësve për metodikë/didaktikë dhe didaktikë profesionale**, kurse afatshkurtra drejtimi për AutoCAD dhe dizajn mode që synojnë arritjen e niveleve profesionale sipas KKK-s. Po ashtu, janë zhvilluar standarde të profesioneve për profilin e tekstit (profili për rrobaqepësi), të transportit dhe të trafikut rrugor (profili drejtues i lëvizjes së trenave);
- Në bashkëpunim me MASHT-in dhe shkollat partnere të AAAPARr-s është shpallur konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2016/2017;
- Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2016/2017;
- Ripërtëritja dhe pajisja me kontrata për mësimdhënësit dhe stafin administrativ sipas nevojave të shkollave dhe në zbatim të ligjeve në fuqi;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të AAAPARr-s, trajnimi i stafit sipas nevojave të AAAPARr-s dhe ftesave nga IKAP-i;
- Janë bërë hapa për t'iu kthyer të hyrave vetjake në buxhetin e shkollave në mënyrë që të zhvillohet normalisht procesi mësimor për të rritur. I janë bërë kërkesa Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Financave dhe kryetarëve të komunave që ta marrim pëlqimin e tyre për lejimin e shfrytëzimit të këtyre të hyrave;
- Nga Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa janë shqyrtuar të gjitha ankesat që i janë drejtuar AAAPARr-s gjatë kësaj periudhe kohore;

- Gjatë gjithë vitit kanë vazhduar të procedohen lëndët në SIMFK për pranimin e mallit dhe certifikim të lëndëve në sistem;
- Është hartuar Plani i Personelit për vitin 2017 dhe është dërguar në MAP për t'u vendosur në sistemin informativ të burimeve njerëzore (SIMBNJ);
- Janë caktuar objektivat në harmoni me planin e punës të vitit 2016 për vlerësimin vjetor të stafit të Agjencisë dhe menaxhmentin e shkollave.

Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Financave


- Sipas Ligjit për Buxhet dhe Financa, është pranuar buxheti për Agjencinë dhe shkollat partnere për vitin 2016 nga MASHT-i në vlerë prej 3 150 235 eurosh;
- Planifikimi i prokurimit për shkollat dhe Agjencinë;
- Planifikimi i rrjedhës së parasë dhe përgatitja e PCF-ve (Planit Financiar të Shkollave dhe Agjencisë për këtë vit);
- Është hartuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve sipas ligjeve në fuqi;
- Sipas kërkesës së MASHT-it, është bërë rishikimi i buxhetit për vitin 2016 sipas afatit të paraparë kohor;
- Është bërë koordinim i vazhdueshëm me shkollat rreth çështjeve financiare dhe të pagesave;
- Janë zotuar, shpenzuar dhe certifikuar 730 lëndë gjatë kësaj periudhe në SIMFK në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi (përmes AAAPARr-s janë lehtësuar procedurat e realizimit të pagesave);
- Regjistrimi i Agjencisë në Administratën Tatimore të Kosovës, pajisja me numër fiskal, njëkohësisht ka filluar deklarimi i tatimit në burim dhe kontributeve pensionale për çdo muaj sipas legjislacionit në fuqi;
- Ka filluar plotësim-ndryshimi i Rregullores për të Hyra Vetjake nga ana e MASHT-it, e Thesarit, e AAAPARr-s dhe aktorëve të tjerë relevantë për grumbullimin dhe shpërndarjen e mjeteve nga të hyrat vetjake për të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar publik;
- Është themeluar komisioni për lejimin e shfrytëzimit të të hyrave vetjake të cilat realizojnë shkollat dhe nuk kanë leje për përdorimin e tyre;
- Trajnim i zyrtares së Financave nga Banka Botërore me temën “Lehtësimi i menaxhimit të financave publike”;
- Menaxhimi i vazhdueshëm i pagave për të gjithë stafin e AAAPARr-s dhe shkollave partnere;
- Raportimi në MASHT në baza mujore për shpenzimet e krijuara nga AAAPARr-ja;
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019;
- Hartimi i Cesh Planit (rrjedhjes së parasë) për mjetet shtesë në kategorinë paga dhe mëditje për tremujorin e fundit të vitit 2016;
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet sipas viteve 2018 dhe 2019; kufijtë buxhetorë të

- pagave në bazë të Qarkores Buxhetore 2017/2 (përgatitja e PCF-s për vitin 2017);
- Përgatitja e realizimit të objektivave për vitin 2016 dhe kërkesat për buxhet shtesë të planeve për objektivat e vitit 2017 nga Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe shkollave partnere dhe dërgimi i saj në MASHT;
 - Marrja pjesë e zyrtares së Financave në seminarin e mbajtur nga ATK-ja me temë “Mbajtja e tatimit në burim në paga dhe kontribute pensionale”;
 - Gjashtë qendrat e kompetencës kanë bërë shpërndarjen e buxhetit nëpër kategori ekonomike për vitin 2017;
 - Është bërë përfundimi i vitit fiskal dhe janë përfunduar raportet vjetore sa i përket sektorit të financave;
 - Mbyllja e “petycash”-eve për Agjencinë dhe shkollat në menaxhim.

Vlerësimi i punës së AAAPARr-s nga shkollat partnere

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr), ka zhvilluar një pyetësor me stafine dyshkollave profesionale dhe të katër Qendrave të Kompetencës që janë në menaxhim të këtij institucioni: Sh.M.L.P “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë; Sh.M.L.T “11 Marsi” në Prizren; Qendra e Kompetencës në Prizren; Qendra e Kompetencës në Skenderaj; Qendra e Kompetencës në Ferizaj dhe Qendra e Kompetencës në Malishevë. Me këtë instrument vlerësimi, për objektiv kishim nxjerrjen në sfond të rezultateve pozitive në të cilat ka ndikuar menaxhimi i ri i këtyre institucioneve. Derisa synim i AAAPARr-së ishte ngritja e kapaciteteve të autonomisë financiare, por edhe menaxheriale. Ky hulumtim, kishte për objektiv nxjerrjen e indikatorëve, që ndikon dhe reflekton pozitivisht me mënyrën edhe të menaxhimit. Përmes pyetjeve të hulumtimit, nxirren përfundime dhe rekomandime që vlejné për periudhën e ardhshme të AAAPARr-së. Mostër e intervistimit ishin 214 persona të përfshirë në intervistim, ku përqindja më e madhe e përgjigjeve janë vlerësuar me notën 4 dhe 5. Që do të thotë, se janë të kënaqur me punën dhe rezultatet e arritura gjatë fazës dy vjeçare të shkollave në menaxhimin e Agjencisë. Ndërsa, tani do të prezantohet pyetësori, ku janë të paraqitura pyetjet sipas vlerësimeve të pjesëmarrësve, të cilat janë të ilustruara edhe me diagrame.

Pyetjet	Vlerësimi prej 1-5					Pjesëmarrës	
	E pa vlerësuar	1	2	3	4		5
1. Brenda shkollës është arritur zhvillimi i kapaciteteve për hartimin e dokumenteve përmbajtësore cilësore.	2	7	18	39	100	48	214
2. Është bërë rekrutimi i stafit bazuar në kritere të qarta cilësie, mbështetur në kornizat ligjore ekzistuese. Cili ishte roli i shkollës në vendimmarrje. Ka ndryshime pozitive krahasuar me të kaluarën?	1	18	17	31	93	54	214
3. Është arritur ngritja e kapaciteteve që do të ndikojnë në autonominë e shkollave lidhur me Zhvillimin e Kurrikulave, ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e përgjithshëm të shkollave, analizimin e modeleve të financimit dhe menaxhmentit financiar. Sa ekzistojnë ndryshimet pozitive?	0	10	23	27	93	61	214
4. Është mbështetur zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimmësuesve dhe personelit në përgjithësi nëpër shkolla.	3	11	22	21	87	70	214
5. Është vendosur koordinimi i shkollës tuaj me shkollat tjera në aspektin e këmbimit të kuadrove, shfrytëzimit të pajisjeve laboratorike, përvojave, punëtorive etj?	3	15	43	53	65	35	214
6. Është arritur fuqizimi i rolit të organeve profesionale të shkollave (Këshillit të shkollës, Këshillit të prindërve dhe Këshillit të nxënësve).	4	16	16	28	98	52	214
7. A është arritur që shkolla të ketë Planin Zhvillimor sipas Kurrikulës dhe dispozitave ligjore ?	1	11	16	27	79	80	214
8. Janë krijuar lidhje më të qëndrueshme të shkollës me komunitetin e biznesit.	1	15	19	38	73	68	214



Pra, qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të prezantohen rezultatet e performancës së AAAPARr-së, që Agjencia ka zhvilluar më shkollat partnere dhe përfitimet e shkollave partnere gjatë kësaj faze pilote në menaxhimin e Agjencisë. Përmes këtij prezantimi kuptuam të arriturat, ndryshimet, përfitimet e shkollave partnere gjatë fazës pilotuese sa janë në menaxhimin e AAAPARr-së. Nga prezantimi i hulumtimit i cili u pasqyrua edhe me diagrame u konstatua që gjatë kësaj faze (2014-2016), ka pasur përfitime të dukshme në menaxhimin e Agjencisë, sa i përket aktiviteteve profesionale (Kurrikula, standarde, Kualifikime, plan programe, Udhëzues, materiale mësimore etj), Personelit, Financave, Trajnimeve, Infrastrukturës etj.